



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.427/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.06.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nuhaj” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-70983-03-07-2017 me objekt: “Blerje pjesë këmbimi dhe riparim i automjeteve të Bashkisë Fier”, me fond limit 2 119 866 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 20.03.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues:

“Nuhaj” sh.p.k
Ruga Nacionale Fier –Patos 500 metra larg Drejtorisë Policisë Qarkut Fier, përballë varrezave Publike Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier
Lagja “Kastriot”, Rruga “Brigada e XI Sulmuese”; Fier,

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e

rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*";

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.03.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit "*Kërkesë për Propozim*" me Nr. REF-70983-03-07-2017 me objekt: "*Blerje pjesë këmbimi dhe riparim i automjeteve të Bashkisë Fier*", me fond limit 2 119 866 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 20.03.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 20.03.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën 3615/1 prot, datë 04.05.2017 protokolluar me tonën me nr. 836/2 datë 11.05.2017 me objekt "*Dërgim informacioni për në lidhje me procedurën e prokurimit "Blerje pjesë këmbimi dhe*

riaparim i automjeteve të Bashkisë Fier”, rezulton se në datën 13.04.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Power Industries	1.551.200	I skualifikuar
- Nuhaj	1.913000	I skualifikuar
- Sila	1.944.800	I kualifikuar

II.3. Në datën 13.04.2017 operatori ekonomik “Nuhaj” shpk, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

• Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit të DST në pikën 2, a dhe b të saj kërkohet që shoqëria të paraqes: Një dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar nga Administrata Tatimore. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur “Vërtetimi i Tatimeve” rezulton se shoqëria Nuhaj ka detyrime në vlerën 50.000 leke. Operatori Nuhaj nuk plotëson pikën 2, a dhe b të kritereve të përgjithshme të kualifikimit, për këtë arsyeje ky operator skualifikohet nga kjo procedurë. Në DST kërkohet që: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim”.

II.3.1. Në datën 18.04.2017 operatori ekonomik “Nuhaj” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

[...]

Fakti 1 Nuk keni shlyer të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të kërkuara në shtojcën 7 të kpp pika 2 b të dst-ve.

Argumenti:

Në lidhje me pagesën e detyrimeve për sigurimet shoqërore “Nuhaj” shpk i ka paguar ato rregullisht por në lidhje me rastin në fjalë është njoftuar dhe Drejtoria e Tatimeve Fier më datë 08.07.2016 me nr. Protokoll 13351 në të cilën është komunikuar se kemi 50.000 lekë gjorbë të nxjerra nga sistemi në muaj të ndryshëm ku njoftohemi se kemi të drejtën e apelimit për 30 ditë. “Nuhaj” shpk ka bërë kërkesën e apelimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë më datë 11.07.2016 brenda afatit të përcaktuar me ligj. Përderisa gjoba ka të drejtë apeli nuk ju lind e drejta për të më skualifikuar në këtë prokurim. Përsa përmendëm më sipër në dokumentat e tenderit bashkangjitur me vërtetimin e tatim taksave ju kemi dërguar njoftimin e vlerësimit të detyrimeve tatimore ku shprehet qartë që janë gjoba dhe jo mospagesa të sigurimeve shoqërore. Një ankesë të tillë shoqëria jonë e ka bërë dhe me tenderin me të njëjtin objekt e zhvilluar në datën 28.07.2016 [...] dhe kjo kërkesë ju pranua.

Argumenti 2 Në lidhje me këto gjoba është pronocuar disa herë Ministri i Financave që do të heqim me ligj dhe faktikisht janë hequr. 2.1. në pikën 2 b, për kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit

b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar nga administrata tatimore “Nuhaj” shpk i ka paguar rregullisht e referuar dhe vërtetimit lëshuar nga administrata tatimore me nr. 32/87prot datë 01.03.2017 ku detyrimi për konteribute dhe kamat vonesa janë 0 janar 2017 deri janar 2017 gjordat janë kundravajtje administrative dhe të apelueshme. Nisur nga sa më sipër AK-ja Bashkia Fier se skualifikimi i kësaj shoqërie është bërë në kundërshtim me LPP-në

II.4. Në datën 26.08.2017, autoriteti kontraktor e ka venë në dijeni ankimesin në lidhje me pretendimet e parashtuara në ankesë ku ka vendosur si më poshtë:

[...]

KSHA-ja pasi shqyrtoi të gjithë dokumentat e vëna në dispozicion për këtë procedurë me anë të procesverbalit i ka komunikuar Kryetarit vendimin si më poshtë:

Të mos pranoj ankesën tuaj për arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi në spe nga ana e KVO-së janë pasqyruar arsyet e skualifikimit të oe “Nuhaj” shpk rezulton se :

Nuk keni shlyer të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të kërkuara në shtojcën 7 të KPP pika 2btë dst-ve.

Vërtetim nga Bashkia Fier që nuk ka asnjë detyrim debie ndaj këtij autoritetio kontraktor ose deklaratë noteriale e oe-së që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Fier.

Certifikatë e Menaxhimit të cilësisë ISO9001:2008 për objektin e prokurimit nuk është në emër të shoqërisë “Nuhaj” shpk si dhe nuk egziston kontrata e bashkëpunimit me shoqëritë që disponojnë këto certifikata.

Për arsyen e mësipërme

Fakti 1 Vërtetim nga Bashkia Fier që nuk ka asnjë detyrim ndaj saj.[...]

Komisioni verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga oe “nuhaj” shpk si dhe përpuethshmërinë e tyre me kriteret e vecanta të kualifikimit të vendosura nga ak-ja dhe konstaton:[...]Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri oe ka paraqitur vërtetimin nr. 695datë 26.07.2016 lëshuar nga njësia administrative Portëz si dhe vërtetimin nr. 478prot datë 27.07.2016 në lidhje me shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2016 pranë Drejtorisë së Taksave në të cilën subjekti figuron i regjistruar si biznes.

[...] Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri oe nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Fier që nuk ka asnjë detyrim debie ndaj këtij autoriteti kontraktor ose një deklaratë noteriale e operatorit që nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Fier.

Vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Fier dhe Njësia Administrative Portez të paraqitura nga oe vërtetojnë faktin se subjekti “Nuhaj” shpk Fier ka likujduar detyrimet që rrjedhion nga detyrimet vendore për vitin 2016 ndërkohë që nëpërmjet tyre nuk provohet nëse subjekti

“Nuhaj” shpk nuk ka detyrime debie, apo e thënë ndryshe nuk është debitor ndaj Bashkisë Fier si institucion detyrime të cilat në vetvete mund të jenë të ndryshme nga pagesa e taksave vendore për vitin 2016.

Për arsyet e mësipërme pretendimi i shoqërisë “Nuhaj” shpk është i pabazuar dhe skualifikimi i bërë nga KVO-ja është i drejtë.

Fakti 2 Nuk janë shlyer të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore .

Në lidhje me pagesën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore subjekti deklaroi se i ka paguar rregullisht dhe detyrimi që përmban vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është gjobë për të cilën subjekti e ka apeluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve brenda 30 ditëve.[...]

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri Komisioni gjykon se detyrimi është gjobë referuar shkresës 13351 prot datë 08.07.2016 është ankimuar duke ndjekur shkallët ligjore të ankimit dhe detyrimet principale janë të paguara.

Për arsyet e mësipërme skualifikimi për këtë pikë është i padrejtë dhe ankesa e subjektit “Nuhaj” shpk për këtë pikë pranohet.

Një tjetër shkak për skualifikimin nga KVO-ja është dhe fakti që certifikatë e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2008 për objektin e prokurimit nuk është në emër të SHOOËRISË “Nuhaj” shpk si dhe nuk egziston kontrata e bashkëpunimit me shoqëritë që e disponojnë këtë certifikatë.

Për këtë pikë subjekti nuk ka paraqitur ankesë si rrjedhojë arsyeja e skualifikimit konsiderohet e pranuar prej tij.

Gjithashtu nga verifikimi rezulton se subjektet objekt i kësaj ankese para zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk kanë bërë ankesë për kërkesat e vecanta të kaulifikimit. Arsyeja e skualifikimit e pranuar nga komisioni nuk e ndryshon klasifikimin e bërë nga kvo-ja pasi pavarësisht saj egzistojnë arsyet e tjera të skualifikimit ndërmjet të cilave oe skualifikohet.

II.5. Në datën 11.05.2017, operatori ekonomik ankimues “Nuhaj” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.6. Njëpërmjet shkresës nr.3615/1 prot., datë 04.05.2017 protokolluar me tonën me nr.836/2 datë 11.05.2017 me objekt “Dërgom informacioni në lidhje me procedurën e prokurimitme objekt “Blerje pjesë këmbimi dhe riparimi i automjeteve të Bashkisë Fier”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.Konkretisht citon:

[..]

Komisioni i Vlerësimit të ofertave për shkak të hedhjes së plotë të shkaqeve të skualifikimit për secilin operator ekonomik kjo dhe për faktin e implementimit të sistemit të ri të prokurimit nga APP-ja, i ka kërkuar titullarit të autoritetit kontraktor me qëllim realizimin e një

vlerësimi sa më të plotë në të gjithë elementët e tij, rivlerësimin në sistemin elektronik të prokurimit të kësaj procedure në mënyrë që të gjitha konstatimet e pasqyruara në procesverbalin e vlerësimit të ofertave të pasqyrohen në mënyrë korrekte në sistemin elektronik të prokurimit. Duke u ndodhur para faktit dhe rrethanave që procedura e prokurimit do të rivlerësohet dhe në momentin e përfundimit të tij operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë të gjitha të drejtat e ligjshme për tu ankimuar ndaj vendimeve të autoritetit kontraktor nga titullari i autoritetit kontraktor është hequr pezullimi i procedurës me qëllim vijimin e procesit të rivlerësimit të procedurës. OE “Nuhaj” shpk ka marrë njoftimin për rivlerësimin e procedurës me objekt “ Blerje pjesë këmbimi dhe riparim i automjeteve të të Bashkisë Fier.Më datën 27.04.2017 pranë autoritetit kontraktor Bashkia Fier është paraqitur një kopje e formularit të ankesës nga oe “Nuhaj” shpk drejtuar KPP-së dhe në vijim jemi njohur në vendimin nr. 836/1 prot datë 28.04.2017 të KPP-së me objekt “Urdhë rper pezullimin procedurë prokurimi dhe shqyrtim në themel”, jemi në pritje tvendimit tuaj.[...]

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nuhaj” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit të DST në pikën 2,a dhe b të saj kërkohet që shoqëria të paraqes: Një dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar nga Administrata Tatimore. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur “Vërtetimi i Tatimeve” rezulton se shoqëria Nuhaj ka detyrime në vlerën 50.000 leke. Operatori Nuhaj nuk plotëson pikën 2, a dhe b të kritereve të përgjithshme të kualifikimit, për këtë arsyeje ky operator skualifikohet nga kjo procedurë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresësn 3615/1 prot, datë 04.05.2017 protokolluar me tonën me nr. 836/2 datë 11.05.2017 me objekt “Dërgim informacioni për në lidhje me procedurën e prokurimit “Blerje pjesë këmbimi dhe riparim i automjeteve të Bashkisë Fier”, rezulton se në datën 13.04.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Power Industries	1.551.200	I skualifikuar
- Nuhaj	1.913000	I skualifikuar
- Sila	1.944.800	I kualifikuar

III.1.3. Në datën 13.04.2017 operatori ekonomik “Nuhaj” shpk, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të DST në pikën 2,a dhe b të saj kërkohet që shoqëria të paraqes: Një dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar nga Administrata Tatimore. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur “Vërtetimi i Tatimeve” rezulton se shoqëria Nuhaj ka detyrime në vlerën 50.000 leke. Operatori Nuhaj nuk plotëson pikën 2, a dhe b të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, për këtë arsyeje ky operator skualifikohet nga kjo procedurë.
- Në DST kërkohet që: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim”.

III.1.4. Referuar shkresës kthim përgjigje të autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues “Nuhaj” shpk, lidhur me këtë arsye skualifikimi argumenton si më poshtë:

[...]

Fakti 2 Nuk janë shlyer të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore .

Në lidhje me pagesën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore subjekti deklaron se i ka paguar rregullisht dhe detyrimi që përmban vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është gjobë për të cilën subjekti e ka apeluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve brenda 30 ditëve.[...]

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri Komisioni gjykon se detyrimi është gjobë referuar shkresës 13351 prot datë 08.07.2016 është ankimuar duke ndjekur shkallët ligjore të ankimit dhe detyrimet principale janë të paguara.

Për arsyet e mësipërme skualifikimi për këtë pikë është i padrejtë dhe ankesa e subjektit “Nuhaj” shpk për këtë pikë pranohet.

Sa më sipër KPP nuk shprehet më tej lidhur me këtë pretendim.

III.2. Gjithashtu referuar Kthim Përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar operatorit ekonomik ankimues “Nuhaj” shpk Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës janë nxjerrë arsye të reja të pakomunikuara nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve këtij të fundit.

III.2.1. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të

Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.” Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 9 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së.

III.2.3. Në rastin konkret K.P.P konstaton se me anë të veprimeve dhe mosveprimeve autoriteti kontraktor në mënyrë të hapur ka shkelur parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, duke rishikuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimes si dhe duke u bërë shkak për zvarritjen e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Pretendimi i autoritetit kontraktor se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të kryejë një vlerësim të dytë për operatorin ekonomik “Nuhaj” shpk me argumentin se nuk i ka komunikuar nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike të gjitha arsyet e skualifikimit për këtë procedurë prokurimi Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është tërësisht i pabazuar në ligj pasi në interpretim të bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni gjykon se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka për kompetencë të vetën funksionale shqyrtimin në tërësi të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit dhe njoftimin e operatorëve ekonomikë për të gjitha arsyet e mundshme të skualifikimit, në mënyrë që këta të fundit të kenë mundësi të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me motivet e skualifikimit dhe të rivendosin të drejtat e tyre nëpërmjet procesit të ankimit, sikundër parashikohet në pikën 2, neni 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar si dhe në pikën 5, të nenit 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar. Në rastin konkret e vetmja arsye që i është komunikuar rregullisht ankimesit është ajo e datës 13.04.2017 ndërsa cdo arsye tjetër që i është komunikuar pas kësaj date dhe që ka ardhur kryesisht nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se bie ndesh me legjislacionin e

prokurimit publik. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendime të tilla, “të reja”, të evidentuara në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit për prokurimin publik nuk mund të merren në shqyrtim.

Gjithashtu në mbështetje të këtij argumenti Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ka një mospërputhje midis arsyeve të skualifikimit të dhëna në procesverbalin e vlerësimit të mbajtur nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në datën 13.04.2017 dhe arsyeve të skualifikimit të komunikura nëpërmjet kthim përgjigjes për shqyrtimin e ankesës. Kjo dëshmon më sëmiri se autoriteti kontraktor ka qënë tërësisht i paqartë në njoftimin e arsyeve të skualifikimit dhe operatori ekonomik ankimues nuk ka përse të penalizohet për mospërmbushje të detyrave funksionale të komisioneve të posaçme të ngritura pranë autoritetit kontraktor për zhvillimin në përputhje me legjislacioni e procedurave të prokurimit.

III.3. Lidhur me arsyen e skulifikimit të operatorit ekonomik “Nuhaj” shpk me arsyetimin se: *“Në DST kërkohet që: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është një arsye e papërcaktuar dhe nuk ka evidentuar në asnjë rast dokumentin konkret i cili është paraqitur i panoterizuar nga operatori ekonomik ankimues. Mospërcaktimi shprehimisht i dokumentit të cilit sipas autoritetit kontraktor i mungon ky element i vlefshmërisë (noterizimi orgjinaliteti) nuk e ka lejuar ankimuesin të paraqesë argumentat e tij lidhur me përmbushjen e këtij kriteri.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nuhaj” shpk për procedurën e prokurimit *“Kërkesë për Propozim”* me Nr. REF-70983-03-07-2017 me objekt: *“Blerje pjesë këmbimi dhe riparim i automjeteve të Bashkisë Fier ”*, me fond limit 2 119 866 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 20.03.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së datë 13.04.2017 mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nuhaj” shpk duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nuhaj” shpk

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.836 Protokoli, Datë 27.04.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

